



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr. _____ prot.

Tiranë, më 9.7.2021

- Lënda:** Parashtrime mbi dokumentacionin e përcjellë nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit, në datën 6.7.2021, që i përkasin ankimit të Komisionerit Publik kundër vendimit nr.183, datë 19.7.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit Petrit Çano
- Baza ligjore:** Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”
- Drejtuar:** Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

Të nderuar anëtarë të trupit gjykues,

1. Në seancën gjyqësore të datës 3.6.2021, në vijim të përgjigjeve të ardhura nga institucionet, trupi gjykues vendosi t’i kërkojë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë informacion plotësues dhe DSIK-së përditësimin e raportit mbi vlerësimin e figurës për subjektin e rivlerësimit, në bazë të nenit 39, të ligjit nr. 84/2016. Raporti duhet të jetë i deklasifikuar në funksion të procesit që po zhvillohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit.
2. Më datë 6.7.2021, në Institucionin e Komisionerëve Publikë, është protokolluar shkresa me nr. ***/** prot., datë ***.7.2021, e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, me anë të cilës është përcjellë dokumentacioni në vijim: (i) Raporti mbi kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit Petrit *** Çano, datë ***.6.2021, i deklasifikuar pjesërisht¹, institucion dërgues Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar; (ii) Shkresë me nr.*** prot., datë ***.6.2021, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, bashkëngjitur së cilës është tabela e titulluar: “Të dhënat e nxjerra referuar shkresës nr. ***/** prot., datë ***.5.2021, për periudhën nga data 1.1.2016 e deri aktualisht”; (iii) Ankesë e shtetasit *** ***, e nënshkruar prej tij dhe nga dy avokatë.
3. Për shkakun ankimor lidhur me kontrollin e figurës, nga *Raporti mbi kontrollin e figurës, i datës ***.6.2021*, rezulton se Grupi i punës, nisur nga të dhënat e siguruar nga autoritetet

¹ Me vendim të KDZH-së nr. ***, datë ***.6.2021.

verifikuese, ndryshon konstatimin fillestar të dhënë për subjektin e rivlerësimit Petrit Çano, nga përshtatshmëri për vazhdimin e detyrës në papërshtatshmëri për vazhdimin e detyrës.

3.1 Në referencë të përmbajtjes së këtij Raporti, pjesërisht të deklasifikuar, rezulton se janë administruar të dhëna që kërkojnë verifikimin në burim të përmbajtjes së tyre, trajtimin procedural të tyre dhe krahasimin eventualisht me praktika të caktuara.

4. Për shkakun ankimor lidhur me vlerësimin e aftësive profesionale, nga *Tabela*, e dërguar prej Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, rezulton se ankime të bëra nga organi i Prokurorisë, sipas viteve, janë:

- Për kërkesat e paraqitura me objekt zbatimin e dispozitës: “*Qëndrim në shtëpi*”, për periudhën 2016-2020, Gjykata ka disponuar me 16 pranim kërkesë, nga të cilat është ushtruar ankim për 1 vendim, në vitin 2019.
- Për kërkesat e paraqitura me objekt zbatimin e dispozitës: “*Lirim me kusht*”, për periudhën 2016-2020, Gjykata ka disponuar me 43 pranim kërkesë, nga të cilat është ushtruar ankim për 8 vendime².
- Për kërkesat e paraqitura me objekt zbatimin e dispozitës: “*Rillogaritje paraburgimi*”, për periudhën 2016-2020, Gjykata ka disponuar me 14 pranim kërkesë, nga të cilat është ushtruar ankim për 1 vendim, në vitin 2020.
- Për kërkesat e paraqitura me objekt zbatimin e dispozitës: “*Njohje amnistie*”, për periudhën 2016-2020, Gjykata ka disponuar me 18 pranim kërkesë, nga të cilat është ushtruar ankim për 1 vendim në vitin 2016 dhe 1 vendim në vitin 2017.

4.1 Referuar ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, një ndër burimet³ mbi bazën e të cilave vlerësohet Drejtuesi/Kryetari i Prokurorisë janë edhe të dhënat statistikore, të cilat, në rastin konkret, të pashoqëruara me analizë për secilin rast mosankimi, pa paragjykuar vendimmarrjen për mosankim, duket se janë të një niveli të ulët, në raport me pranimet e kërkesave të të dënuarve nga Gjykata.

4.2 Gjendur në këtë situatë fakti, Komisioneri Publik rezervon të drejtën për t’u shprehur, pasi të dëgjojë shpjegimet e subjektit të rivlerësimit, në lidhje me këto të dhëna statistikore dhe mënyrën e ushtrimit të kompetencës së tij procedurale.

5. Lidhur me ankesën e datës ***.7.2021, paraqitur nga shtetasi ***. ***, në dukje, akti i plotëson formalisht kërkesat e nenit 53 të ligjit nr. 84/2016 dhe mbetet në vlerësimin e trupës administrimi i tij, sa kohë konstatohet se denoncuesi, njëkohësisht, i është drejtuar institucioneve të juridiksionit të zakonshëm disiplinor (KLP/ILD), ashtu sikurse edhe KPA-së.

KOMISIONERI PUBLIK

Florian BALLHYSA

² Në vitin 2016 për 1 vendim, në vitin 2017 për 2 vendime, në vitin 2018 për 1 vendim, në vitin 2019 për 2 vendime, në vitin 2020 për 2 vendime.

³ Neni 82 i ligjit nr. 96/2016.